



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense



Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs/Human Resources Directorate

Bazuar në Ligjin nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Ligjin nr.08/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, Ligjin nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ligjin nr. 08/L-156 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, nenin 5, paragrafin 1, nënparagrafin 1.1 të Rregullores nr. 07/2023 për Rekrutim në FSK, si dhe duke pasur për bazë ofertën e Akademisë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ministria e Mbrojtjes shpall:

K O N K U R S

Ministria e Mbrojtjes do të nominojë gjashtë kandidatë për të studiuar në Akademinë Ushtarake të SHBA-së, andaj ftohen të gjithë të interesuarit për të konkurruar.

I. PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES PËR TË STUDIUAR NË AKADEMINË USHTARAKE NË SHBA

Për t'u nominuar për studime në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe për t'u rekrutuar si kadet në Forcën e Sigurisë së Kosovës, aplikanti duhet t'i plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi;
- Të ketë kryer shkollën e mesme, përfshirë edhe testin kombëtar të maturës;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit;
- Të mos jetë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;
- Të jetë i moshës 18 vjeç në ditën e fillimit të studimeve akademike;
- Të mos ketë kaluar ditëlindjen e 23-të në ditën e fillimit të vitit akademik (më 1 korrik 2027);
- Meshkujt duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm, ndërsa femrat duhet të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 160 cm (kjo verifikohet gjatë testimit fizik);
- Aplikantët të cilët bartin tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrahë nga pjesa e bicepsit deri te gishtat e dorës, duke përfshirë edhe pirsingun, në rast të përzgjedhjes janë të obliguar të bëjnë heqjen e tyre paraprakisht në afatin kohor deri në fillimin e shkollimit për kadet, në të kundërtën diskualifikohen;

- Aplikantët duhet të njohin gjuhën angleze, si dhe të kenë notën mesatare gjatë shkollimit të mesëm jo më të ulët se 3.0;
- Aplikantët që konkurrojnë nga shoqëria civile dhe përzgjidhen për studime, marrin statusin e kadetit dhe përfitojnë pagën e kadetit të FSK-së deri në përfundimin e studimeve;
- Pjesëtarët e FSK-së të cilët përzgjidhen për studime marrin statusin e kadetit dhe përfitojnë pagën e kadetit të FSK-së deri në përfundimin e studimeve;
- Aplikantët që përzgjidhen nga shoqëria civile, nëse nuk arrijnë t'i përfundojnë studimet, i nënshtrohen kritereve sanksionuese të kontratës;
- Pjesëtarët e FSK-së të cilët përzgjidhen për studime dhe marrin statusin e kadetit, në rast të dështimit në përfundimin e studimeve, i nënshtrohen kritereve sanksionuese të kontratës;
- Kadetët dhe pjesëtarët e FSK-së që ndjekin shkollimin në akademitë ushtarake janë të obliguar të shërbejnë dyfishin e kohës së shkollimit, e cila rregullohet dhe përcaktohet me kontratë;
- Dhënia e informatave të rrejshme kurdo që zbulohet, gjatë procesit të rekrutimit apo gjatë shërbimit në FSK, rezulton me largim nga FSK-ja.

Kriteret e shtetit pritës:

- Të mos jetë bartës i virusit HIV, hepatitit B apo sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme dhe të mos vuajë ose të mos ketë vuajtur nga sëmundje të zemrës, veshkave, mëlçisë, mushkërive, sëmundje neuropsikiatrike, të sistemit lokomotor apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i substancave narkotike;
- Të ketë shikim të mirë dhe pa ndonjë problem dentar të theksuar;
- Të ketë rezultate minimale të matematikës në SAT prej 580 pikëve dhe EBRW 480 pikë ose minimumi i matematikës/shkencës dhe arsytimit në ACT prej 25 pikëve dhe në anglisht/lexim prej 18 pikësh;
- Të kalojë me sukses testin fizik, Candidate Fitness Assessment (CFA), i cili përbëhet nga: 1. hedhja e topit të basketbollit; 2. tërheqje në hekur; 3. vrapim i shpejtë vajtje–ardhje 36 m (40-yard); 4. ulje–ngritje mbi duar (pompa); 5. barkore; dhe 6. vrapim 1600 m (një milje);
- Të mos jetë i martuar, të mos jetë shtatzënë dhe të mos jetë nën obligim për t'u kujdesur për fëmijë.

Llojet e testimeve dhe procedurat e vlerësimit për aplikantët:

- Test fizik;
- Test për koeficient të inteligjencës (IQ);
- Test për njohuri të përgjithshme;
- Intervistë;
- Test mjekësor.

Aplikanti kalon në fazën pasuese të testimit vetëm pasi ta ketë kaluar me sukses testin paraprak, me përjashtim të testit për koeficient të inteligjencës (IQ) dhe testit për njohuri të përgjithshme, të cilat zhvillohen njëkohësisht.

Llojet e testimeve dhe procedurat e vlerësimit për aplikantët sipas kritereve të palës pritëse:

- Ese në gjuhën angleze;
- Test TOEFL;
- Test SAT;
- Test fizik Candidate Fitness Assessment (CFA);
- Intervistë nga pala pritëse.

E drejta e ankesës:

- Të drejtën e ankesës e ka çdo aplikant pas publikimit të rezultateve në çdo fazë të testimit;
- Rezultatet publikohen në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të FSK-së;
- Aplikantët e eliminuar kanë të drejtë ankese brenda afatit dyditor;
- Afati i ankesës rrjedh ditën pasuese pas publikimit të rezultatit;
- Ankesa paraqitet në Zyrën për Rekrutim të FSK-së përmes postës elektronike, në adresën: rekrutimi@fsk-rks.org;
- E drejta e ankesës sipas kësaj procedure për aplikantët që konkurrojnë për kadetë aplikohet për të gjitha llojet e testimit ku është përgjegjëse FSK-ja.

Kushtet e tjera:

- Për t'u marrë në konsideratë dokumentet e nevojshme gjatë aplikimit, diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet t'i nënshtrohen procesit të njohjes nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe të sillen të nostrifikuara;

- Përzgjedhja për kadetë është e kushtëzuar me kalimin e suksesshëm të verifikimit të sigurisë;
- Aplikantët e përzgjedhur për kadetë, do të nënshkruajnë kontratën e shkollimit me FSK-në me të cilën përcaktohen obligimet që ata do të marrin si kadetë të FSK-së, si mbajtja e standardeve të larta të shkollimit akademik, gjendjes fizike, sjelljes dhe disiplinës. Mospërbushja e obligimeve të parapara me kontratë në cilindo vit të shkollimit do të rezultojë në humbjen e statusit të kadetit.

II. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR TË APLIKUAR

- Diplomë e shkollës së mesme, (diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i nënshtrohen procesit të njohjes nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Ekstrakt i lindjes (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
- Certifikatë nga gjykata që vërteton se aplikanti nuk është i dënuar dhe nuk është nën hetime penale (dokumenti të jetë i nxjerrë brenda afatit të konkursit);
- Kopje të letërnjoftimit apo pasaportës;
- Fotografi portreti 4x4 për aplikim (elektronike);
- Dëshmi për kualifikime të tjera (nëse posedon);
- Dëshmi për zotësinë e veprimit.

III. AFATI PËR APLIKIM

Konkursi për përzgjedhjen e aplikantëve do të jetë i hapur nga data 24.08.2026 deri më 07.09.2026.

Procesi i aplikimit:

Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike (online) përmes platformës së rekrutimit në adresën: <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply>, ndërsa njoftimin për shpalljen e konkursit e gjeni në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes: <https://mod.rks-gov.net>.

Aplikantët duhet të plotësojnë formularin për aplikim online, i cili gjendet në ueb-faqen zyrtare të FSK-së në adresën: <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply>.

Aplikantët duhet t'i plotësojnë kriteret e konkursit. Ata duhet t'i bashkëngjisnin dokumentet e nevojshme duke pasur parasysh kërkesat e paraqitura në formular.

Aplikimi mund të bëhet deri në ditën e fundit, më 07.09.2026, në orën 23:59.

Për informata plotësuese mund të kontaktoni Zyrën për Rekrutim në FSK nëpërmjet numrit: 038 555 584/5690, apo edhe në numrin: 038 555 584/5691 nga ora 09:00–15:00.

Ministria e Mbrojtjes u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe mirëpret interesimin e të rejave dhe të rinjve për t'u bërë pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

IV. INFORMACION PËR TESTIMET SAT DHE TOEFL

Testimi SAT (Scholastic Assessment Test)

- Regjistrimi për testimin SAT bëhet përmes ueb-faqes zyrtare të SAT.
- Aplikantët duhet të respektojnë afatet e regjistrimit të publikuara në ueb-faqen zyrtare.
- Në Prishtinë janë të autorizuar dy qendra testimi për zhvillimin e testit SAT.

Për informata lidhur me regjistrimin, datat e testimit dhe qendrat e autorizuar, vizitoni:

- <https://collegereadiness.collegeboard.org/sat/register/international>
- <https://collegereadiness.collegeboard.org/sat/register/find-test-centers>

Testimi TOEFL (Test of English as a Foreign Language)

- Testimi TOEFL vlerëson njohuritë e gjuhës angleze dhe është pjesë e kërkesave për pranim në Akademinë Ushtarake të SHBA-së.
- Në Prishtinë janë të autorizuar dy qendra testimi për zhvillimin e testit TOEFL.
- Aplikantët duhet të regjistrohen dhe të informohen për datat e testimit përmes ueb-faqes zyrtare të TOEFL.

Për informata lidhur me regjistrimin, datat e testimit dhe qendrat e autorizuar, vizitoni:

- https://v2.ereg.ets.org/ereg/public/testcenter/availability/seats?_p=TEL